


ÇFARË ËSHTË MARKETINGU TELEFONIK ?



**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE**

**INFORMATION AND
DATA PROTECTION
COMMISSIONER**

ÇFARË ËSHTË MARKETINGU TELEFONIK ?

Ndërgjegjësim i të gjithë kontrolluesve dhe operatorëve në rolin e përpunuesit të kontraktuar, të cilët vetëm ose në bashkëpunim të ndërsjellët kryejnë marketingun nëpërmjet telefonit.

Kontrolluesit, të cilët realizojnë komunikimet e tyre tregtare me karakter reklame (ose promocion) përmes mesazheve, telefonatave, faks-ve ose thirrjeve të automatizuara vetë ose nëpërmjet kompanive të ndryshme, të cilat kanë si objekt të punës së tyre shërbimet e marketingut dhe të komunikimit ndërmjet marketingut telefonik, duhet që ta kryejnë këtë shërbim duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private.

Zbatimi i kërkesave të parashikuara në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim përpunimin e drejtë e të ligjshëm të të dhënave personale, është i rëndësishëm për garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe, në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private.




CILI ËSHTË ...

Pajtimtar/Subjekt: çdo person fizik, juridik, i cili me anë të një kontrate me një ofrues të shërbimeve merr shërbimin telefonik.

Operatori/Përpunuesi i kontraktuar: çdo person fizik ose juridik, i cili dëshiron të bëjë përpunimin e të dhënave personale me anë të një kontrate të lidhur me kontrolluesin e interesuar, për qëllim të dërgimit të materialeve reklamuese ose shitjen e drejtpërdrejtë ose për kryerjen e studimit të tregut ose komunikim tregtar, përmes përdorimit të telefonit.

I. Kërkesat e përgjithshme

1. Nëse pajtimtari, nuk ka dhënë pëlqimin për të marrë telefonata me qëllim telemarketingu në numrin e tij, kontrolluesi duhet ta respektojë këtë kërkesë.
2. Dhënia e pëlqimit nga ana e pajtimtarit nevojitet si për numrin e telefonit fiks ashtu dhe për numrin celular.
3. Pajtimtari në çdo moment mund të tërheqë dhënien e pëlqimit të tij, në këtë rast përpunuesi është i detyruar ta vendosi në listen e pajtimtarëve që nuk kanë dhënë pëlqim.



4. Çdo kontrollues që dëshiron të reklamojë nëpërmjet telefonit duhet të identifikohet dhe kur i kërkohet duhet të jepet një numër pa pagesë dhe një adresë e saktë e kompanisë.

II. Realizimi i komunikimeve tregtare nëpërmjet operatorëve.

- Çdo kontrollues i cili kontraktton një operator për realizimin e thirrjeve me qëllim reklamimi është vetë përgjegjës për rastet e mos respektimit të kërkesave ligjore për ruajtjen e privatësisë.
- Në rastet kur reklamimi me anë të thirrjeve telefonike realizohet nga operatorët, personeli i tij nuk është i detyruar të japë emrat e tyre por duhet të japë emrin e kompanive produktet e të cilëve janë duke reklamuar.
- Në rastet kur pajtimtari nuk ka dhënë pëlqimin për të marrë telefonata me qëllim telemarketingu në numrin e tij ose ka tërhequr dhënien e pëlqimit, kontrolluesi si dhe operatori nuk duhet ta fshinë nga listat e tyre por duhet ta vendosin në një listë të veçante në mënyrë që të mos kontaktohen më.

- III. Në rastet kur një numer telefoni fiks përdoret nga disa pjesëtarë të familjes dhe personi në emrin e të cilit është lidhur kontrata, nuk ka dhënë pëlqimin e tij do të thotë se ka bërë një kundërshtim të përgjithshëm në emër të të gjithë familjes.

IV. Mund të bëhet marketing vetëm nëse pajtimtari ka njoftuar se mund ta bëjë telemarketingun për një produkt të caktuar.

V. Organizata jo fitimprurëse ose çdo kontrollues, për qëllime të caktuara nuk kanë të drejtë të kryejnë thirrje ndaj pajtimtarëve të cilët nuk kanë dhënë pëlqimin për marrjen e telefonatave me qëllim telemarketingu.

VI. Kontrolluesi dhe përpunuesi i kontraktuar duhet të marrin masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale të pajtimtarëve të cilët kanë dhënë pëlqimin për marrjen e telefonatave me qëllim marketingun telefonik.

VII. Kryerja e marketingut telefonik pa dhënë pëlqimin pajtimtari konsiderohet shkelje e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe dënohet me gjobë nga 10.000 deri në 50.000 lekë.




**Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit
dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

Rr. e Kavajës, Nd 80, H.1, Tiranë

+355 4 22237200

info@idp.al; www.idp.al



**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE**

**INFORMATION AND
DATA PROTECTION
COMMISSIONER**